



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1. nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafin 63.1.1. nënparagrafi b) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Wood Corporation” Sh.P.K. të datës 19.04.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 14.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me inventar për QPS-Prishtinë” me nr. të prokurimit 616-23-1336-1-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Wood Corporation” Sh.P.K. e datës 19.04.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 14.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me inventar për QPS-Prishtinë” me nr. të prokurimit 616-23-1336-1-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “Wood Corporation” Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik “Wood Corporation” Sh.P.K. (tutje “parashtruesi”) me datë 20.04.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 14.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me inventar për QPS-Prishtinë” me nr. të prokurimit 616-23-1336-1-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

## **Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:**

**Pretendimi i parë** - *“Garancioni i tenderit/polica e sigurimit është lëshuar nga data 20.03.2023 (aktive për 90 ditë) ndërsa data e dorëzimit të tenderit ishte 21.03.2023 dhe nga kjo datë kërkohej garancioni i tenderit të vlej për 90 ditë, që do të thotë se garancionit i operatorit ishte aktiv për 89 ditë apo 1 ditë më pak sesa kërkesa e dosjes së tenderit”.*

**Pretendimi i dytë** - *“Aneksi 6 është modifikuar dhe i njëjti nuk është sipas kërkesave të dosjes së tenderit pasi që mungojnë të paktën tre kategori të informatave”.*

**Pretendimi i tretë** - *“Çmimi i ofertuar me TVSH dhe pa TVSH në FDT nuk përputhen, që do të thotë se operatori ka një gabim aritmetik dhe këtë përmisim nuk e ka bërë autoriteti kontraktues sipas obligimit”.*

**Pretendimi i katërt** - *“Autoriteti kontraktues ka rekomanduar për ddhënie të kontratës operatorin Mobelland i cili ishte më i shtrenjtë për 0.42 Euro sesa oferta e Wood Corporation”.*

Për shkak të pretendimeve si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues – Komuna e Prishtinës në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 57 dhe 72 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje “LPP”) si dhe nenin 38 dhe 40 të Rregullores (A01) nr.001/2022 për Prokurimin Publik (tutje “RRPP”).

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 28.03.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim.

Për shqyrtimin e pretendimit të parashtruesit, janë administruar këto prova materiale:

- Njoftimi për kontratë dhe dosja e tenderit të dt. 24.02.2023;
- Oferta e tenderuesit të rekomanduar;
- Raporti i vlerësimit të tenderëve i dt. 06.04.2023;
- Procesverbali i hapjes së tenderëve 21.03.2023;
- Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues i datës 14.04.2023;

Pas trajtimit të kërkesës për rishqyrtim është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme dhe nuk ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar pretendimet e tij. Po ashtu nga provat e administruara nuk është arritur që të vërtetohen pretendimet e parashtruesit sipas nenit 62 paragrafit 62.1 nënparagrafi d) të RRPP.

Me qëllim të shqyrtimit të **pretendimit të parë** është administruar dosja e ofertës së tenderuesit të rekomanduar ku ndër të tjera është gjetur edhe deklarata e garantuesit – siguria e tenderit si pjesë përbërëse e polices me nr. 111424 ku përcaktohet se kjo “siguri vlen nga data 20.03.2023 deri me datë 18.06.2023”. Njëkohësisht është administruar edhe DT dhe FDT ku është gjetur se kërkesa për tenderuesit ka qenë sigurimi i tenderit për 90 ditë nga hapja e tenderëve që nënkupton nga data 21.03.2023 deri me datë 18.06.2023. Në këtë mënyrë është gjetur se periudha 90 ditore (21.03.2023-18-06.2023) është e mbuluar tërësisht nga sigurimi i tenderuesit të rekomanduar. Prandaj pretendimi i parashtruesit se sigurimi është bërë vetëm për 89 ditë apo 1 ditë më pak nuk qëndron. Rrjedhimisht është gjetur se pretendimi i parë i parashtruesit është i pabazuar.

**Sa i përket pretendimit të dytë** duhet cekur se sipas dosjes së tenderit (kapaciteti teknik dhe profesional) është kërkuar lista e plotësuar aneksi 6 i DT ku duhet saktësuar “*titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin si dhe listës ti bashkangjiten referencat ose certifikatat për kryerje të furnizimeve*”. Në këtë drejtim është administruar si provë edhe raporti i vlerësimit të tenderëve si dhe dëshmia e kërkuar dokumentare nga tenderuesi i rekomanduar. Komisioni vlerësues ka konstatuar se ky kriter është plotësuar në mënyrë të rregullt nga tenderuesi i rekomanduar. Njëkohësisht edhe nga provat e administruara është konfirmuar ky konstatim i komisionit vlerësues. Në këtë mënyrë është gjetur se edhe pretendimi i dytë i parashtruesit është i pabazuar.

**Sa i përket pretendimit të tretë** ku parashtruesi pretendon se “*Çmimi i ofertuar me TVSH dhe pa TVSH në FDT nuk përputhen, që do të thotë se operatori ka një gabim aritmetik*” fillimisht duhet cekur se parashtruesi nuk ka specifikuar se ku ka ndodhur ky gabim aritmetik. Pra nëse parashtruesi pretendon se ekziston një mospërputhje apo një gabim i caktuar në ofertën e tenderuesit të rekomanduar, atëherë parashtruesi duhet të tregoj saktësisht për cilin gabim bëhet fjala dhe si ka ardhur deri te ky gabim. Përtej formulimit të saktë dhe konkret të pretendimit, parashtruesi e ka edhe barrën e të provuarit (*onus probandi*) për pretendimet e vet. Në të kundërtën nëse nuk tregohet se konkretisht ku është shkelja dhe nuk argumentohet pretendimi në fjalë, atëherë ky pretendim është i paqëndrueshëm në tërësi. Prandaj edhe pretendimi i tretë i parashtruesit është i pabazuar.

Me qëllim të shqyrtimit të **pretendimit të katërt** janë administruar si prova procesverbali i hapjes së tenderëve si njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues. Në të dy këto dy dokumente evidentohet se çmimi final (me TVSH) me të cilin ka ofertuar parashtruesi dhe tenderuesi i rekomanduar është i njëjtë. Përndryshe ky fakt nuk është kontestues as nga vet parashtruesi pasi që pretendimi i parashtruesit i referohet çmimeve pa TVSH me të cilat është ofertuar. Pra nuk qëndron fakti se tenderuesi i rekomanduar ka ofertuar me çmim (final) më të shtrenjtë se parashtruesi. Kuptohet se komisioni vlerësues ka marrë parasysh çmimin përfundimtar (gjithpërfshirës, me TVSH) të tenderuesve dhe jo çmimet tjera që janë pjesë alikuote (përbërëse) të çmimit përfundimtar. Kjo për arsye se për autoritetin kontraktues rëndësia e çmimit si kriter përzgjedhës ka rëndësi në kuptim ekskluziv të pagesës që duhet të paguhet në fund sipas buxhetit të paraplanifikuar. Prandaj edhe pretendimi i katërt i parashtruesit është i pabazuar.


Sipas trajtimit dhe elaborimeve më lartë në këtë vendim është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimet e parashtruesit janë tërësisht të pabazuara. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të RRPP.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 28.04.2023**

**Visar SHEHU**  
  
Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komunale Prishtinës

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.